29	2.515	F.V Pilete dysHEMEJE d50	cope	22.0
30	An	F.V Pilete tarrace Ø 110 mm	cope	17.0
31		F.V Elemente ndihmese + rakorderi (reduksion, brage, bryla etj.)	kompl	1.0
32	An	F.V Kapese tubosh ( kollare te galvanizuara per tubo)	cope	145.0
		<b>Shkarkimi i rrjetit te jashtem te ujrave te zeza</b>		
33	2.1	F.V Germim dhe transport dheu per kanalet e tubove dhe pusetave	m <sup>3</sup>	80.0
34	2.261	F.V Shtrese rere	m <sup>3</sup>	24.0
35	An	F.V Puseta betoni (60 x 60 ) cm, me kapak gize Ø60 cm	cope	13.0
36	An	F.V Tubo PP magjistrali i rrudhosur SN8 Ø 200 mm	ml	116.0
37	An	F.V Tubo PP magjistrali i rrudhosur SN8 Ø 250 mm	ml	40.0
		<b>Shkarkimi i rrjetit te jashtem te ujrave te shiut</b>		
38	2.1	F.V Germim dhe transport dheu per kanalet e tubove dhe pusetave	m <sup>3</sup>	150.0
39	2.261	F.V Shtrese rere	m <sup>3</sup>	45.0
40	An	Pusete shiu 40 x 60, me kapak gize grile 40x60	cope	18.0
41	An	F.V Tubo PP magjistrali i rrudhosur SN8 Ø 200 mm	ml	162.0
42	An	F.V Tubo PP magjistrali i rrudhosur SN8 Ø 250 mm	ml	53.0
43	An	F.V Tubo PP magjistrali i rrudhosur SN8 Ø 315 mm	ml	72.0
		<b>Shuma C-5</b>	<b>dollar</b>	
<b>C-6</b>		<b>Pajisjet per sistemin e shkarkimit te ujrave te zeza</b>		
		<b>Shkarkimet ne planimetri te WC-ve</b>		



	An	F.V.Grupi I pompimit te ujrave te bardha - Prurja: 15 m <sup>3</sup> / h - Prevalenca: 10mkH <sub>2</sub> O	ml	3.0
		<b>Shuma C-6</b>	<b>dollar</b>	
		<b>SHUMA C ( C-1 +C3+C5 ) PA PAJISJET</b>	<b>dollar</b>	
<b>KAP.</b>		<b>PERMBLEDHJE</b>		
<b>POROSITES : KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPERISE</b>				
<b>A</b>		<b>PUNIMET NDERTIMORE TE OBJEKTIT</b>		
<b>B</b>		<b>PUNIMET ELEKTRIKE</b>		
<b>C</b>		<b>PUNIME TE INSTALIME MEKANIKE (HIDROSANITARE, NGROHJE, MBR. NGA ZJARRI) -Pa pajisjet</b>		
<b>D</b>		<b>SIGURIMI NE OBJEKT</b>	muaj	24
		<b>SHUMA - A+B+C (DOLLAR)</b>		
		<b>FONDI REZERVE 5% (DOLLAR)</b>		
	<b>1</b>	<b>SHUMA (DOLLAR)</b>		
	<b>2</b>	<b>T.V.SH.</b>		
	<b>3</b>	<b>PAJISJE MEKANIKE (C2+C4+C6)</b>		
		<b>VLERA TOTALE 1+2+3</b>		

**Për Komunitetin Mysliman të Shqipërisë (KMSH)**

**Kryetari**

**H. Bujar SPAHIU**

Nr. Prot. \_\_\_\_\_

Tirane \_\_\_\_/\_\_\_\_/2022

**KONTRATE SIPERMARRJE  
(KUSHTET E PËRGJITHSHME)**

**PER OBJEKTIN E NDERTIMIT**

**“PAZARI NAMAZGJASE”**

**2022**

## KONTRATE SIPERMARRJE

### “PAZARI NAMAZGJASE”

Ne mbështetje të Kodit Civil, Neni 850 dhe në vazhdim; Marrëveshjes lidhur ndërmjet Komunitetit Mysliman i Shqipërisë dhe Bankës ..... për bashkëfinancimin e zbatimit të projektit “Ndërtimi i qendrës tregtare Pazari i Namazgjase”, nenit 21, Kreu IV “Ekzekutimi dhe Mbikëqyrja e Kontratës” dhe në vijim të Rregullave të Prokurimit të Komunitetit Mysliman i Shqipërisë si dhe Paketës së Tenderimit me objekt “Ndërtimi i Qendrës Tregtare Pazari i Namazgjase”;

Sot, me datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2022, nënshkruhet kjo kontratë sipërmarrje midis **“Porositësit”**:

**Komunitetit Mysliman i Shqipërisë**, përfaqësuar nga z. \_\_\_\_\_, në cilësinë e Titullarit, me adresë në Rrugë “Gerge W. Bush”, Nr.50 Tiranë, Shqipëri, madhor dhe me cilësi juridike të plote për të vepruar

Dhe **“Kontraktorit”**

.....  
.....  
.....  
.....

DUKE QENE SE:

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në cilësinë e Porositësit ka organizuar procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtimi i Qendrës Tregtare Pazari i Namazgjase”;

Shoqëria “.....” shpik është shpallur si shoqëria fituese e procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtimi i Qendrës Tregtare Pazari i Namazgjase”;

Porositësi dëshiron të kontraktojë të shoqëria fituese e procedurës së prokurimit referuar si Kontraktori realizimin e punimeve të objektit “Ndërtimi i Qendrës Tregtare Pazari i Namazgjase”;

Porositësi dhe Kontraktori bien dakot të lidhin këtë kontratë sipërmarrje sipas termave juridike si më poshtë:

## **OBJEKTI I KONTRATES**

Objekti i kësaj kontrate është sipërmarrja me objekt “Ndërtimi i Qendrës Tregtare Pazari i Namazgjase” në përputhje të plotë me projekt - zbatimin e objektit.

## **VLERA E KONTRATËS**

Vlera totale e kontratës pa TVSH është: \_\_\_\_\_  
( \_\_\_\_\_ ) lekë.

Vlera totale e kontratës me TVSH është: \_\_\_\_\_  
( \_\_\_\_\_ ) lekë.

Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës, nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruara nga kontraktori në ofertën e tij.

## **AFATI I REALIZIMIT TË KONTRATËS**

Afati kohor për realizimin e kontratës është 20 (njëzet) muaj kalendarikë, duke nisur nga momenti i nënshkrimit të kontratës nga palët.

Pjesë përbërëse të kontratës përfundimtare që do të nënshkruhet do të jënë:

Janë pjesë përbërëse të pandara të kësaj kontrate:

- Kushtet e përgjithshme të kontratës;
- Kushtet e veçanta të kontratës;
- Oferta financiare & Preventivi Punimeve e paraqitur nga kontraktori (Bashkëlidhur kontratës);
- Metodologjia e Punimeve/Propozimi Teknik e paraqitur nga kontraktori (Bashkëlidhur kontratës);
- Grafiku i realizimit të punimeve/Propozimi Teknik e paraqitur nga kontraktori (Bashkëlidhur kontratës);
- Lista e Stafit për realizimin e objektit/Propozimi Teknik e paraqitur nga kontraktori (Bashkëlidhur kontratës);
- Kontrata për Shërbime Mbikëqyrjeje e lidhur ndërmjet Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe shoqërisë Illyrian Consulting Engineers Sh.p.k, nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.2022.

**Për POROSITESIN**  
**KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPERISE**

**Për KONTRAKTORIN**  
**Shoqëria**

## KUSHTET E PËRGJITHSHME ( "PAZARI I NAMAZGJASE", ELBASAN )

### **Neni 1: QELLIMI**

Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruar në bazë të Rregullave të Prokurimit të Porositësit dhe Kodit Civil ndryshuar.

Për kryerjen e Punëve do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil Shqiptar. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

### **Neni 2: PËRKUFIZIME**

Termet e përdorura në kontratë do të kuptohen dhe interpretohen si më poshtë:

- a. **"Preventiv për njësi"** do të thotë volumet e punës të dhëna në projekt shoqëruar me çmimet për njësi të pandryshuara që janë pjesë e Ofertës në një kontratë me punime në matje.
- b. **"Afati i realizimit të punimeve"** do të thotë data që Punët duhet të përfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve, e vërtetuar nga Investitori.
- c. **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Investitorit dhe Sipërmarrësit dhe të gjitha bashkëngjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentet e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- d. **"Çmim kontrate"** do të thotë çmimi që i paguhet Sipërmarrësit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.
- e. **"Realizimi i punimeve"** do të thotë data e vërtetuar nga Investitori se Punët janë mbaruar.
- f. **"Defekt"** do të thotë çdo pjesë e Punimeve e papërfunduar në përputhje me kontratën.
- g. **"Data e hyrjes"** do të thotë data që Investitori lejon Sipërmarrësin në kantier.
- h. **"Data e fillimit"** është data kur Sipërmarrësi do të fillojë punimet e ndërtimit. Nëse kjo nuk realizohet, "data e fillimit" do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- i. **"Pajisje"** do të thotë makineritë dhe veglat e Sipërmarrësit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndërtimeve.
- j. **"Materiale"** do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga Sipërmarrësi për kryerjen e punimeve.
- k. **"Objekt i kontratës"** do të thotë të gjitha Punët që Sipërmarrësi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- l. **"Palë(t)"** do të thotë nënshkruesit e kontratës.

- m. **“Mbikëqyrës Punimesh”** do të thotë personi i emëruar nga Investitori që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Investitorin.
- n. **“Investitor/Porosites”** do të thotë Komuniteti Mysliman i Shqipërisë që është pjese e kësaj kontrate dhe që kontraktin punët objekt i kësaj kontrate.
- o. **“Kantier”** do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- p. **“Raport i inspektimit të kantierit”** do të thotë dokumentet e bashkëlidhur kontratës që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- q. **“NënSipërmarrës”** do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të Sipërmarrësit.
- r. **“Sipërmarrës/kontraktori”** do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- s. **“Standarte Teknike”** do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- t. **“Ngritja e kantierit”** do të thotë punimet e ndërtimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- u. **“Punime”** do të thotë ajo që Investitori i kërkon nga Sipërmarrësi të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në anekset pjese të kësaj kontrate.
- v. **“Pranimi Paraprak”** do të thotë pranimi nga ana e Investitorit të kompletimit me sukses të provave të pranimit pjesor ose të plote, përpara fillimit të periudhës së garancisë, dhe lëshimi i Certifikatës së Pranimit Paraprak.
- w. **“Certifikata e Pranimit Paraprak”** do të thotë dokumenti që vërteton se mallrat janë pranuar paraprakisht në përputhje me termat e Kontratës. Certifikata do të lëshohet kur Punimet do të inspektohen dhe testohen nga Investitori.
- x. **“Pranimi Përfundimtar”** do të thotë Pranimi nga ana e Investitorit, në fund të periudhës së garancisë, dhe lëshimi i Certifikatës së Pranimit Përfundimtar.
- y. **“Certifikata e Pranimit Përfundimtar”** do të thotë dokumenti që vërteton se punimet janë pranuar përfundimisht nga investitori në përputhje me termat e Kontratës.

### **Neni 3: HARTIMI I KONTRATËS**

3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar nga Porositësi.

3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

### **Neni 4: INFORMACIONI KONFIDENCIAL**

4.1 Kontraktori dhe Porositësi duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

4.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumente të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Porositësi, deri në masën e kërkuar që nënkontraktori të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencë siç thuhet në Paragrafin 4.1 më sipër.

## **Neni 5: PRONA INTELEKTUALE**

5.1 Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Porositësit, i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

5.2 Kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Porositësit të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, të mbledhura ose të përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumenteve dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën apo pa leje paraprake me shkrim nga Porositësit.

5.3 Kontraktori duhet t'i garantojë Porositësit zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

5.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Porositësit në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Porositësit të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

## **Neni 6: ORIGJINA E MATERIALEVE**

6.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve. Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.

6.2 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. Materialet janë prodhuar, kur nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

6.3 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

## **Neni 7: TË DREJTAT DHE DETYRIMET E POROSITESIT**

7.1 Porositësi me nënshkrimin e kësaj kontrate deklaron se ka dhënë pëlqimin për ndërtimin e objektit sipas kushteve të kësaj kontrate dhe se nuk do ja jap këtë të drejtë asnjë subjekti tjetër derisa kjo kontratë të jetë në fuqi.

7.2 Porositësi ka detyrim të vërë në dispozicion të Sipërmarrësit pronën dhe dokumentacionin përkatës me qëllim ndërtimin e ndërtimit objekt Kontrate.

7.3 Porositësi ka detyrimin ti paguaj Sipërmarrësit pagesat sipas kushteve të rëna dakord në kushtet e veçanta të kontratës.

7.4 Porositësi nga afati i fillimit deri në afatin e realizimit të plotë do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës

ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Porositësi apo nga çdo person i punësuar/kontraktuar nga Porositësi, përveç kontraktorit.

7.5 Porositësi nga afati i fillimit deri ne afatin e realizimit te plote do te jete përgjegjës për dëmtim te Punimeve, materialeve dhe pajisjeve, deri ne atë mate qe lidhet me fajin e Porositësit apo me projektin e tij.

## **Neni 8: TE DREJTAT DHE DETYRIMET E SIPËRMARRËSI**

8.1 Kontraktori merr përsipër të kryejë punimet e ndërtimit sipas kushteve të rëna dakord në kontratë, duke zbatuar rregullat teknike të parashikuara dhe të kërkuara në Lejen e Zhvillimit/Lejen e Ndërtimit si dhe parashikimeve përkatëse të legjislacionit shqiptar.

8.2 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me Propozimin Teknik te paraqitur prej tij dhe shpallur fitues, pjese përbërëse e kontratës, specifikimet teknike të paraqitura në dokumentet e tenderit.

8.3 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Porositësi, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë te Porositësi.

8.4 Kontraktori duhet te kryeje dhe mbaroje Punimet me stafin propozuar për realizimin e objektit, pjese përbërëse e kontratës. Stafi është i detyruar te jete i pranishëm gjate gjithë kohëzgjatjes se punimeve për realizimin e objektit. Ne rast mospërmbushje nga ana e Kontraktorit do te rezultojë ne ndërprerje te marrëdhënies kontraktuale.

8.5 Kontraktori duhet te filloje zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet ti mbaroje Punët brenda Afatit te Mbarimit paraqitur ne Grafikun e realizimit te punimeve, pjese përbërëse e Kontratës.

8.5 Kontraktori merr përsipër dhe mban përgjegjësinë dhe për instruktimin dhe zbatimin e rregullave të sigurimit teknik të punonjësve në objektet e ndërtimit. Masat administrative ose sanksionet e vendosura nga organet shtetërore të specializuara të shkeljeve të mësipërme.

8.6 Kontraktori është i detyruar te përmbush te gjithë detyrimet qe rrjedhin nga Ligji nr. 8402 date 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve te Ndërtimit”, te ndryshuar, kuadri ligjor ne fuqi.

8.7 Kontraktori merr përsipër te kryeje për llogari te Porositësit praktiken e regjistrimit te objektit te përfunduar pranë Zyrës se Kadastrës.

8.8 Kontraktori garanton me shpenzimet e veta çdo dëm të mundshëm, që mund të vijë si shkak i cilësisë së punimeve, brenda apo jashtë ambienteve të saj.

## **Neni 9: MBIKQYRESI I PUNIMEVE**



9.1 Mbikëqyrësi i Punimeve do të jetë një subjekt i zgjedhur nga Porositësi, i cili do të behet i njohur në kontratën që do të nënshkruhet mes palëve.

9.2 Mbikëqyrësi i Punimeve do vendose për çështjet e kontratës midis Kontraktorit dhe Porositësit, bazuar në kontratën e lidhur nga Porositësi dhe Mbikëqyrësit.

9.3 Mbikëqyrësi i Punimeve duhet të kontrollojë punimet e ekzekutuara nga Sipërmarrësi dhe duhet të konfirmojë shumen që duhet t'i paguhet Sipërmarrësit brenda 10 (dhjete) ditëve pune nga data që Sipërmarrësi ka paraqitur situacionin pranë tij.

## **Neni 10: KANTIERI**

10.1 Kantieri i ndërtimeve do të jetë pasuria me të dhëna: ASHK Drejtoria Vendore Elbasan, ZK. 8522, Nr. Pasurie 9/70, Lloji i Pasurisë: truall me sip. 4500 m<sup>2</sup>.

10.2 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

10.3 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit të Mbikëqyrësi për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

10.4 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

10.5 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, lëndëve të përbëra organike të rrezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

10.6 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin vetëm me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Porositësi siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikun për realizimin e Punimeve.

10.7 Porositësi duhet t'i japë të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes parashikuar në këtë kontratë. Nëse disponimin i ndonjë pjese të kantierit, ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në këtë kontratë nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin, do të konsiderohet se Porositësi ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktori i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Porositësi dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

10.8 Data e Hyrjes së Kontraktorit në Kantier do të jete brenda 7 ditëve nga data e lidhjes së kontratës.

10.9 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

10.10 Porositësi nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

10.11 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohet për të vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë Mbikëqyrësin për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e Mbikëqyrësit për procedurën e administrimit të objekteve.

#### **Neni 11: GRAFIKU I REALIZIMIT TE PUNIMEVE**

11.1 Data e fillimit të punimeve do të jetë menjëherë pas Plotësimit të Proces-Verbalit të Dorëzimit të Kantierit dhe Proces-Verbalit të Fillimit të Punimeve.

11.2 Programi i punimeve, në të cilin tregohet mënyra dhe grafiku kohor i lëvrimin e kryerjes së punimeve të ndërtimit, montimit dhe të provës së veprës, sipas afatit të propozuar prej tij për të gjitha veprimtaritë e punimeve janë paraqitur në Propozimin Teknik bashkëlidhur me këtë kontratë si pjesë përbërëse e saj.

11.3 Sipërmarrësi do të kryejë punimet në përputhje me programin e punimeve, të paraqitur dhe do të përfundojë ato brenda periudhës së kërkuar të përfundimit të punimeve.

11.4 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga Mbikëqyrësi, Kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

11.5 Kontraktori duhet të paralajmërojë Mbikëqyrësin sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

#### **Neni 12: CILESIA E PUNIMEVE, TESTIMET DHE INSPEKTIMET**

12.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

12.2 Sapo të lidhë kontratën, Kontraktori duhet t'i paraqesë Mbikëqyrësit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

12.3 Mbikëqyrësit duhet të kontrollojë punën e Kontraktorit dhe të njoftojë kontraktori për defekte që mund të jenë gjetur.

12.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, Kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

12.5 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktori brenda çmimit të kontratës.

12.6 Porositësi me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të Kontraktorit, Kontraktori duhet të sigurojë leje për Porositësi për të ndjekur këto teste dhe inspektime.

12.7 Porositësi, gjithashtu, mund t'i kërkojë Kontraktorit të bëjë teste ose inspektime shtesë të parashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë në përputhje me specifikimet dhe kushtet e kontratës. Porositësi do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto

teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Porositësi do të bjerë dakord të ndryshojë Grafikon për realizimin e Punimeve.

12.8 Porositësi do të refuzojë çdo punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e kërkuara në zbatimin e kontratës.

12.9 As ekzekutimi i testeve, as inspektimi i punimeve nuk do ta lirojë Kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

### **Neni 13: GARANCIA PËR PUNIMET DHE KORRIGJIMI I DEFEKTEVE**

13.1 Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.

13.2 Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

13.3 Garancia e punimeve të kontratës do të jete në masën 5.% të vlerës së kontratës dhe do të jete e vlefshme për një **periudhë 24 (njëzet e katër ) mujore**, pas përfundimit të punimeve.

13.4 Mbikëqyrësi i Punimeve do të njoftojë Kontraktorin lidhur me çdo defekt para mbarimit të periudhës së garancisë për defektet. Periudha e garancisë për defektet do të shtyhet deri sa të korrigjohen defektet.

13.5 Çdo herë që të njoftohet një defekt, Kontraktori do të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar nga njoftimi i Mbikëqyrësit të punimeve.

13.6 Në qoftë se Kontraktori nuk korrigjon defektin/ defektet brenda afatit të përcaktuar në njoftimin e Mbikëqyrësit të punimeve, ky i fundit do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, dhe Kontraktori do të paguajë këtë shumë, ose Investitori do t'i mbajë këto shumë duke i zbritur nga pagesat pasardhëse.

### **Neni 14: ÇMIMI I KONTRATES DHE KUSHTET E PAGESAVE**

14.1 Vlera e kontratës (pagesa) do të jetë jo më shumë se vlera limit e përcaktuar në shpalljen e tenderit.

14.2 Çmimet e Kontraktorit për punimet e kryera sipas Kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruara nga Kontraktori në ofertën e tij.

14.3 Çmimi i kontratës, duhet të paguhet siç specifikohet në kontratë.

14.4 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të parashikohet në KVK. Kur bëhet një pagesë e parashikuar, kontraktori duhet të paraqesë një komunikatë me situacionin e muajit tek Mbikëqyrësi ku deklaron se plani sipas Grafikut për realizimin e Punimeve është përmbushur. Komunikata gjithashtu, duhet të shprehë vlerën e punës së ekzekutuar duke hequr

shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korigjimit të një defekti.

14.5 Mbikëqyrësi duhet të kontrollojë punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit nga Porositësi, brenda 15 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek Mbikëqyrësi.

14.6 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i Grafikut për realizimin e Punimeve është verifikuar nga Mbikëqyrësi.

14.7 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Porositësit, sipas vlerës së punimeve të marra përsipër nga secili prej tyre për çdo situacionin.

### **Neni 15: PREVENTIVI**

15.1 Preventivi do të përshijë të gjitha pajisjet e materialet, zërat e punimeve për ndërtimin, montimin dhe provat që duhet të kryhen nga Kontraktori, me cikël te plote për përfundimin e punimeve sipas specifikimeve teknike.

15.2 Preventivi dhe oferta do të përdoren për të llogaritur vlerën e kontratës. Kjo vlerë është fikse dhe nuk mund të tejkalohet me përjashtim te rasteve te parashikuara ne kontratë nëse ka.

15.3 Kjo Kontratë do të jetë kontratë me punime matje faktike dhe me çmime për njësi te pandryshueshme, referuar çmimeve te ofertës se Kontraktorit, sikurse specifikohet në Ofertën Financiarë & Preventivi Punimeve bashkëlidhur me këtë kontrate si pjese përbërëse, integrale e saj.

15.4 Kontraktori është i detyruar te verifikojë origjinën dhe cilësinë e materialeve me kërkesë te Mbikëqyrësit te punimeve.

### **Neni 16: VONESA NE ZBATIM DHE ZGJATJA E AFATIT**

16.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe në këtë kontratë, Kontraktori duhet te filloje zbatimin e kontratës menjëherë.

16.2 Me përjashtim kur Investitori është dakort për zgjatje te afatit te kontratës, Porositësi ka te drejte te kërkoj të dëmshpërblehet për demet për vonesën ne zbatim ne se Kontraktori dështon ne dorëzimin e Ndërtimeve brenda datës se kryerjes se plote te specifikuar ne kontrate.

16.3 Porositësi mund te zbresë shumen e dëmeve te likuiduara qe duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktorit, mënyra e përlllogaritës së masës së demit do përcaktohet në Kontratë. Ne një rast te tille Porositësi duhet t'i japi Kontraktorit njoftim me shkrim për shumen dhe arsyen e zbritjes.

16.4 Porositësi do të jete dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.

16.5 Porositësi mund të jete dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin tij për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktori duhet të njoftojë menjëherë Porositësin me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Investitori duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Porositësi është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës, nënshkruar nga Porositësi, Kontraktori dhe Mbikëqyrësi.

16.6 Rastet për arsye të të cilave vonesat justifikohen, do të konsiderohen sa vijon:

- Mbikëqyrësi i projektit urdhëron shtyrjen ose nuk jep skicat (vizatimet, specifikimet ose udhëzimet e nevojshme për kryerjen e punimeve në kohën e caktuar.
- Mbikëqyrësi i projekti udhëzon Kontraktorin për të zbuluar punime të fshehta ose për të kryer prove pas kryerjes së punimeve dhe punimet rezultojnë pa defekte.
- Investitori shkakton vonesa ose shpenzime shtese për Kontraktorin.
- Vonesa e kryerjes së pagesave të radhës për çdo vërtetim punimesh
- Porositësi vonon në mënyrë të paarsyeshme lëshimin e miratimit të Certifikatës së marrjes në dorëzim provizor të objektit ose certifikatës së pranimit përfundimtar të punimeve të objektit.

16.7 Kompensimi i rasteve të sipërpërmendura do të bëhet duke shtyrë datën e përfundimit të punimeve.

## **Neni 17: PERSONELI DHE MAKINERITE**

17.1 Sipërmarrësi do angazhojë personel të kualifikuar drejtues e zbatues për drejtimin, kryerjen dhe përfundimin e Punimeve të parashikuara në programin e miratuar nga Porositësi, pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

17.2 Personeli i angazhuar për drejtimin, zbatimin dhe kryerjen e punimeve deri në përfundimin e tyre do të jete sipas propozimit teknik miratuar dhe përzgjedhur si fitues, bashkëlidhur me këtë kontratë si pjesë përbërëse e saj.

17.3 Personeli do të jete i disponueshëm në kantier me kohë të plote përgjatë gjithë kohës së realizimit të punimeve.

17.4 Kontraktori për qëllime të realizimit të ndërtimit duhet të ketë në dispozicion makineritë e pajisjet e përshkruara në kriteret e kualifikimit. Makineritë dhe Pajisjet do të jene në dispozicion për kryerjen e punimeve përgjatë gjithë afatit të realizimit të punimeve.

## **Neni 18: PËRGJEGJËSIA PËR DËMET DHE SIGURIMI TEKNIK.**

18.1 Kontraktori është përgjegjës për sigurimin teknik të të gjitha veprimtarive në kantierin e punimeve. Nga data e fillimit e deri në përfundimin e nënshkrimit të Certifikatës së Pranimit Përfundimtar të Punimeve, Kontraktori do të përballojë rreziqet

për shkak të dëmtimeve personale, vdekjes dhe humbjes ose dëmtimi të pasurisë (përfshirë pa kufizime, punimet, materialet dhe pajisjet).

18.2 Nga data e hyrjes ne fuqi te Kontratës deri në Datën e Mbarimit, Kontraktori është përgjegjës për të gjitha dëmtimet e mëposhtëmve:

- a) Për dëmtime ose humbje te Ndërtimeve dhe Materialeve.
- b) Për dëmtime ose humbje te pajisjeve.
- c) Për dëmtime ose humbje te pasurisë.
- d) Për dëmtim personal ose vdekje te personave ne kantier.

18.3 Kontraktori mban përgjegjësi të plotë për sigurinë e qëndrueshmërinë mekanike te Objektit ne qofte se bene ndërhyrje te pa parashikuara ne projektin e projektuar nga arkitekti i investitorit, si edhe përdorimin e materialeve cilësore te ndërtimit brenda specifikimeve teknike dhe standartëve ne fuqi.

18.4 Kontraktori mban përgjegjësi të plotë për dëmet që mund t'i shkaktohen Kontraktuesve ose personave të tretë gjatë ndërtimit të objektit për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në realizimin e ndërtimit

18.5 Objekti duhet ndërtohet konform Kushteve Teknike te Zbatimit te miratuara. Po ashtu ne Zbatim duhet te reflektohen te gjitha kërkesat funksionale e teknologjike te dhëna ne Projekt.

18.6 Sipërmarrësi është përgjegjës për plotësimin e te gjithë dokumentacionit te nevojshëm dhe detyrimeve qe burojnë nga legjislacioni ne fuqi dhe ne mënyre te veçante me subjektet shtetërore.

## **Neni 19: SHPENZIMET E RIMBURSUESHME DHE KOSTOJA E RIPARIMEVE**

19.1 Kontrata nuk ka shpenzime të rimbursueshme, përjashtim bëjnë ato shpenzime të cilat palët me një marrëveshje të dytë me shkrim pranojnë rimbursim për shpenzime të caktuara

19.2 Dëmtimi i punimeve ose humbja e materialeve që do të përdoren për punimet nga dita e fillimit deri në pranimin përfundimtar të punimeve, do të mbulohen nga Sipërmarrësi me shpenzimet e tij .

19.3 Riparimet qe dalin te nevojshme gjate kolaudimit te veprës, nëse janë për shkak te mosplotësimit te kërkesave te kontratës ose te punës jo cilësore te Kontraktorit, do te mbulohen nga ky i fundit me shpenzimet e tij.

19.4 Kontraktori nuk do te ketë të drejtë të kërkoj nga Porositësi të dëmshpërblehet për demet e shkaktuara nga forca madhore si tërmete, përmytje apo gjendje te tjera te jashtëzakonshme qe mund te ndodhin gjate zbatimin te punimeve, te cilat janë jashtë kontrollit te tij.

## **Neni 20: FORCA MADHORE**

20.1 Asnjëra nga palët nuk do të jete përgjegjëse për humbjet, apo shtyrjen e realizimit të detyrave të tyre respektive sipas kontratës, në rastet e shfaqjeve të ngjarjeve të forcave madhore, si zjarret natyrore, vullkane, embargo, luftime, mobilizim, termite, kur këto ngjarje provohen apo shpallen në rrugë zyrtare.

20.2 Pala që ndikohet (pengohet) nga ngjarjet e forcave madhore është e detyruar të njoftojë menjëherë me shkrim palën tjetër brenda 5 ditëve nga shfaqja e këtyre ngjarjeve. Përtej këtij fakti palët duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tyre sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatim që nuk pengohen nga Forca Madhore.

20.3 Në qoftë se kontrata prishet si rrjedhim i forcës madhore Porositësi do të lëshojë një certifikatë që vërteton se kontrata është e prishur, pa pasur asnjë penalitet kundrejt Sipërmarrësit dhe anasjelltas.

20.4 Për sa më sipër, Sipërmarrësi do të sigurojë kantierin e punimeve dhe do të ndërpresë punimet sa më shpejt që të jete e mundur pasi të ketë marrë këtë certifikatë. Ai do të paguhet vetëm për punët që ka kryer para marrjes së certifikatës.

## **Neni 21: NDRYSHIMI I POROSISE**

21.1 Këto kushte nuk janë subjekt ri negocimi dhe Amendimi pas hyrjes në fuqi, me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës.

21.2 Porositësi në çdo kohë, mund të porosisë Sipërmarrësin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

- Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- Korrigjime në materiale
- Korrigjime në sasi

21.3 Përpara se të kërkojë një ndryshim, Porositësi dhe Kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materializojë amendamentet e marrëveshjes. Porositësi nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrëveshjes.

## **Neni 22: MARRJA NE DOREZIM E PUNIMEVE**

22.1 Kontraktori mbas përfundimit të punimeve, i paraqet Mbikëqyrësit të Punimeve dokumentacionin dhe llogaritjet përfundimtare për punimet e kryera, të cilat Mbikëqyrësi i Punimeve mbasi bën verifikimin nga ana e tij brenda 7 (shtatë) ditëve, së bashku me relacionin e tij ia paraqet Porositësit.

22.2 Porositësi, në rast se gjatë kolaudimit të veprës konstaton defekte, të cilat janë pasoje e punës jo cilësore të Porositësit, do t'ia paraqesë atij me shkrim dhe do të kërkojë riparimin e tyre brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.

22.3 Pas riparimit te defekteve, ne se ka, si dhe korrigejmeve te nevojshme ne llogarinë përfundimtare te shumes totale dhe mbas marrjes se Proces-Verbalit te Kolaudimit, Porositësi do te beje pagesat e parashikuara ne Kontrate dhe do te miratoje certifikatën e marrjes ne dorëzimin paraprak te punimeve.

22.4 Pas përfundimit te periudhës se garancisë për defektet, Kontraktori i paraqet për miratim Porositësit Certifikatën e Pranimit Përfundimtar ne 1 një origjinal dhe 2 dy kopje.

### **Neni 23: ZGJIDHJA E KONTRATES**

23.1 Porositësi mund të zgjedh të pezulloje ose zgjidh kontratën në mënyrë të njëanshme, duke njoftuar 15 ditë para palën tjetër, në çdo kohë në tërësi ose pjesërisht ne qofte se Kontraktori bën shkelje themelore te kontratës.

23.2 Shkelje themelore te Kontratës përfshijnë, por nuk kufizohen ne, sa vijon:

- a) Kontraktori ndalon punimet për 15 (pesëmbëdhjete) dite kur nuk parashikohet ndërprerja e punës ne programin aktual dhe ndalimi i punës nuk është autorizuar nga Mbikëqyrësi i Punimeve/ Mbikëqyrës projekti;
- b) Kontraktori falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë ose fillon likuidimin për arsye te tjera përveç rindërtimit ose bashkimit te shoqërisë;
- c) Mbikëqyrësi i Punimeve/ Mbikëqyrës projekti dërgon njoftimin se moskorrigjimi i një defekti te posaçëm paraqet shkelje themelore te kontratës dhe Kontraktori nuk e korrigjon atë brenda 30 tridhjete ditëve te përcaktuara nga Mbikëqyrësi i Punimeve;
- d) Kontraktori vonon kryerjen e punimeve me një numër ditësh për te cilat shuma maksimale e dëmshpërblimeve qe duhen paguar tejkalon shumen qe përcaktohet ne sigurimin e kontratës;
- e) Kur mbikëqyrësi i punimeve e njofton Porositësin se Kontraktori ka dështuar të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës, është Porositësi ai që do te vendose ne se shkelja është themelore ose jo;

23.3 Ne rast se kontrata priset si pasoje e një shkelje themelore te kontratës nga Kontraktori, ky i fundit do te largohet nga kantieri dhe paguan dëmshpërblimin 100 % (njëqind për qind) te vlerës se punimeve te pambaruara te paguara.

23.4 Ne rast se kontrata priset nga Porositësi për arsye te shkeljes themelore te kontratës nga Kontraktori ose për arsye te tjera objektive, Mbikëqyrësi i Punimeve do te lëshoje një Certificate për vlerën e punimeve te kryera, për materialet e porositura, për shpenzimet e Kontraktorit, për mbrojtjen dhe sigurimin e punimeve, duke zbritur pagesat e marra nga Kontraktori deri ditën e lëshimit te Certifikatës.

23.5 Pa marre parasysh sa u tha me lart Porositësi kur ka një arsye objektive, mund te prishe kontratën duke i dhënë Kontraktorit një njoftim me shkrim brenda një afati prej 30 tridhjete ditësh.

23.6 Kontraktori mund të mund te zgjedh pezulloje ose zgjidh kontratën në mënyrë të njëanshme, duke njoftuar 15 ditë para palën tjetër, në çdo kohë në tërësi ose pjesërisht ne qofte se Investitori bën shkelje themelore te kontratës.



23.7 Shkelje themelore te Kontratës përfshijnë, sa vijon:

a) Porositësi dështon të bëj pagesat brenda afateve të rëna dakord në kontratë.

b) Porositësi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë ose fillon likuidimin.

23.7 Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfunduar do të bëhen pronë e Porositësit pa kundërshpërblim për punimet e kryera, nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim te kushteve te saj nga ana e sipërmarrësit.

23.8 Po ashtu në rast se Kontraktori ndërpret punimet në objekt për çdo lloj shkak, pasi ka kryer një pjesë të veprës, dhe brenda 3 muajve nuk gjen një ndërtues të ri me të cilin Investitori të jetë dakord për vijimin e punimeve, ky investim shkon pa kundërshpërblim në favor të Porositësit, i cili ka të drejtë të zbatoj projektin duke kontraktuar me subjekte të tjerë.

## **Neni 24: KOMUNIKIMI**

24.1 Palët bien dakord që të gjitha komunikimet ndërmjet tyre do të bëhen me shkrim, nëpërmjet dërgimit të shkresës përkatëse në adresat e tyre fizike si dhe me anë të postës elektronike (e-mail). Njoftimi do te ketë efekt sapo te dorëzohet.

## **Neni 25: DISPOZITA PERFUNDIMTARE**

25.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindi midis palëve për interpretimin apo zbatimin e Kontratës, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet me mirëkuptim kompetente për zgjidhjen e saj do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

25.2 Kushtet e përcaktuara në kontratë interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti.

25.3 Kjo Kontratë përbën marrëveshjen ekskluzive të palëve. Çdo ndryshim i saj mund të bëhet vetëm me pëlqimin e shprehur me shkrim. Ndryshimet e bëra nga secila palë në mënyrë të njëanshme nuk mund të prodhojnë asnjë efekt ligjor.

25.4 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Sipërmarrësit

25.5 Pavlefshmëritë, ndryshimet ose shtesat e pjesshme të kësaj Kontrate nuk bëjnë të pavlefshme tërësinë e Kontratës, pjesa tjetër mbetet ashtu sikurse është nënshkruar nga palët.

25.6 Për çfarë nuk është parashikuar në mënyrë të shprehur në këtë Kontratë palët do ti referohen rregullimeve të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

25.7 Çdo Pale duhet të emërojë me shkrim një person ose strukturë organizative, që do të jetë përgjegjës/e, në emër të pales, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e pales në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.

25.8 Te gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe

25.8 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

25.9 Kontrata që do të nënshkruhet përbehet nga kushtet e përgjithshme, kushtet e veçanta dhe anekset e listuara, të cilat janë pjesë përbërëse integrale e kontratës. Struktura e kontratës do të jetë: